



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:204636

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05533368

C.nr. 2559/14

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Egzon Mujaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.B., nga P., të cilin e përfaqëson R.S., avokat nga P. kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me seli në P., me objekt kontesti, vërtetim pronësie, jashtë seancës me datë 02.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SE ËSHTË TERHEQUR padia me numër C.nr.2559/14, e datës 19.09.2014, e paditësit R.B., nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me seli në P., për vërtetim pronësie.

A r s y e t i m

Paditësi R.B, nga P., në këtë gjykatë me datë 19.09.2014, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, me seli në P., për vërtetim pronësie.

Gjykata në seancën e shqyrtimit përgatitor të mbajtur me 20.03.2024, ka konstatuar se pala paditëse për këtë seancë është ftuar në mënyrë të rregullt pasi që nga fletë dërgesa që gjendet në shkresat e lëndës rezulton se përfaqësuesi i paditësit e ka pranuar ftesën me datë 04.03.2024, ku ishte njoftuar për datën dhe kohën e mbajtjes së seancës, në seancë nuk ka prezantuar dhe mos prezencën nuk e ka arsyetuar.

E paditura nuk ka kërkuar që seanca të mbahet në mungesë të palës paditëse, por ka kërkuar që të konsiderohet e tërhequr padia e palës paditëse.

Meqenëse pala paditëse edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt në seancë nuk ka prezantuar, gjykata në bazë të nenit 409 të LPK-së, ka marr aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit kundër të paditurës dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm

C.nr. 2559/14, datë 02.04.2024

Gjyqtari  
Egzon Mujaj

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.